



Komuniteti i Praktikës për Raportimin Financiar (KP-KRF), PULSAR

Vjenë, 21-22 nëntor 2019


Kontabiliteti i aktiveve të qëndrueshme -
çështjet kryesore që marrin përgjigje në
SEKSP

Lívia Shinn Straková - Ekipi EPSAS, Komisioni Evropian - EUROSTAT

Puna përgatitore për vendosjen e standardeve SEKSP në të ardhmen: Kontabiliteti i aktiveve të qëndrueshme


1. *Studimi i PwC-së 2014*
2. *Udhëzuesi për zbatimin për herë të parë të SEKSP-ve*
3. *Materialet e SEKSP-ve për:*
 - *Aktivet infrastrukturore*
 - *Aktivet ushtarake*
 - *Aktivet e trashëgimisë*
4. *SEKSP – zhvillimet aktuale*

Numri i qeverive që mbajnë inventar fizik të aktiveve të qëndrueshme



Burimi: Analizat e PwC-së mbi standardet SNKSP dhe zbatimin e tyre në Shtetet Anëtare të BE-së (2014)

Numri i qeverive që i njohin aktivet e qëndrueshme në pasqyrën e pozicionit financiar




Udhëzuesi për zbatimin për herë të parë të SEKSP-ve

Udhëzuesi i FTI-së fokusohet te mbështetja e nxjerrjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të njësive ekonomike të sektorit publik, përdorimin e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe, në veçanti, pasqyrën e bilancit çelës të nxjerrë për herë të parë mbi të drejtat dhe detyrimet e konstatuara.

➤ **Njohja**

Pasqyra e pozicionit financiar (pasqyra e bilancit)

- **Aktivet afatgjata materiale (AAM)**, në veçanti pasuritë e paluajtshme dhe aktivet infrastrukturore
- **Aktivet e trashëgimisë**
- **Pajisje ushtarake**



FTI - AAM

➤ Matja fillestare

Pemë ilustruese e vendimmarrjes

Materiale të çështjeve SEKSP

2016 – 2017

- Njësi të vogla dhe me më pak risk
- Opsionet në SNKSP
- Tatim-taksat
- **Trashëgimia**
- Përfitimet e punonjësve
- Përfitimet sociale
- **Aktivet infrastrukturore**
- Raportimi i segmenteve
- **Aktivet ushtarake**
- Kontributet shoqërore

2017 – 2018

- Aktivet afatgjata jo-materiale
- Plani kontabël
- Dhënia e informacioneve shpjeguese
- Provigjionet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara, dorëzanitë financiare
- Huatë dhe huamarrja
- Normat e skontimit
- Grantet dhe dërgesat e tjera
- Nocioni i kontrollit
- Konsolidimi i pasqyrave financiare
- Marrëveshjet koncesionare

Materiale të çështjeve SEKSP – përmbajtja

- *Porositur me qëllim për të siguruar që SEKSP-të të bazohen në informacioneve mbi çështjet që janë ngritur si me rëndësi të veçantë nga ekspertët e Shteteve Anëtare dhe palët e interesit të SEKSP-ve*
- *Dokumentet mbulojnë tema të tilla si:*
 - *trajtimi kontabël në SNKSP, SNRF, vetë rregullat kontabël të Komisionit, Shtete Anëtare të përzgjedhura, ESA/GFS, kuadri kontabël i NATO-së (NAF)*
 - *pikat problematike/çështjet në lidhje me përkufizimin, njohjen, matjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese*
 - *anët pozitive dhe negative të qasjeve ekzistuese*
 - *Rrugët e mundshme që mund të ndiqen për SEKSP-të në të ardhmen*

Dokument i çështjeve mbi AKTIVET INFRASTRUKTURE


Përse janë aktivet infrastrukturore të rëndësishme për kontabilitetin në sektorin publik?

- Aktualisht një prej zërave me rëndësi më të madhe materiale në AAM
- Aktivet e paluajtshme të specializuara me potencial të konsiderueshëm shërbimi dhe/ose përfitime ekonomike të konsiderueshme
- Mbështetja e investimeve në këto aktive është një prej prioriteteve kryesore të KE-së

Sfidat për kontabilitetin e aktiveve infrastrukturore:

- Në nivel ndërkombëtar nuk ekziston asnjë standard specifik për kontabilitetin e aktiveve infrastrukturore
- SNKSP 17 konsiderohet nga disa Shtete Anëtare si problematik për kontabilitetin dhe matjen e infrastrukturën publike, p.sh., qasja me komponentë
- Kontabilizimi i infrastrukturës sipas SNKSP-ve konsiderohet si kompleks (p.sh., inventarizimi, zhvlerësimi)
- [link - EPSAS IP on Infrastructure assets](#)

Aktivet infrastrukturore – në nivel të qeverisjes qendrore



Burimi: Analizat e PwC-së mbi standardet SNKSP dhe zbatimin e tyre në Shtetet Anëtare të BE-së (2014)

Dokument i çështjeve mbi AKTIVET USHTARAKE


Përse janë aktivet ushtarake të rëndësishme për kontabilitetin në sektorin publik?

- *Aktivet ushtarake mund të jenë një gamë e gjerë aktivesh*
- *Aktive civile (p.sh., zyra) dhe aktive specifike (p.sh., armë bërthamore)*
- *Në nivel ndërkombëtar, nuk ka asnjë standard specifik për trajtimin kontabël të aktiveve ushtarake; SNKSP 17 zbatohet edhe për aktivet ushtarake*

Sfidat për kontabilitetin e aktiveve ushtarake

- *Vështirësitë kryesore praktike dhe pikat e ndjeshme që mund të lindin në lidhje me njohjen dhe matjen e aktiveve ushtarake dhe mënyra si mund të zgjidhen*
- *Nevojitet inventarizimi i plotë dhe njohja e aktiveve ushtarake në bilancin çelës*
- *[link - EPSAS IP on Military assets](#)*

Aktivitet ushtarake – në nivel të qeverisjes qendrore



Burimi: Analizat e PwC-së mbi standardet SNKSP dhe zbatimin e tyre në Shtetet Anëtare të BE-së (2014)

Dokument i çështjeve mbi AKTIVET E TRASHËGIMISË

Përse janë aktivet e trashëgimisë të rëndësishme për kontabilitetin në sektorin publik?

- *Vlera kulturore*
- *Shpesh me vëllim dhe rëndësi të madhe*
- *Ruajtja për brezat e ardhshëm*

Sfidat për kontabilitetin e aktiveve të trashëgimisë

- *Ndalimet/kufizimet mbi heqjen nga pronësia*
- *Vlerësimi i aktiveve të trashëgimisë:*
- *Vlera mund të rritet me kalimin e kohës edhe nëse ka amortizim fizik*
- *Përcaktimi i kostos së ruajtjes së trashëgimisë dhe kontabilizimi i detyrimeve të lidhura*
- *[link - EPSAS IP on Heritage assets](#)*

SEKSP – zhvillimet aktuale

Analizimi i standardeve SNSKP kundrejt kuadrit konceptual të SEKSP-ve

- *Verifikim i përputhshmërisë së standardeve të veçanta SNKSP me kuadrin konceptual të SEKSP-ve, me qëllim të sigurohet baza informative për vendosjen e standardeve SEKSP në të ardhmen*
- *Zbatohet një pilot që mbulon tri standarde SNKSP me kompleksitet të ndryshëm: SNKSP 2, SNKSP 17 dhe SNKSP 41*

Puna e SEKSP mbi matjen

- ***Konceptuale:*** *Si u shërbejnë bazat e ndryshme të matjes së aktiveve dhe pasiveve objektive, në veçanti llogaridhënies dhe vendimmarrjes, së raportimit financiar në kuadër të SEKSP-ve?*
- ***Praktike:*** *Zhvillimi i analizës lidhur me bazat e matjes*

Faleminderit !

Komisioni Evropian– Eurostat – SEKSP:

<https://ec.europa.eu/eurostat/web/epsas/>

CIRCABC depository:

<https://circabc.europa.eu/w/browse/18db61bc-6649-44b3-af14-17fcd1c1216c>